



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-11629/25 datë:19.05.2025



Npi – 01/206 datë: 29.05.2025

**PLANI I PUNËS SË EKIPIT PËR
TË DREJTAT E FËMIJËVE
2025 – 2027**

Shtime 2025



Npi – 01/206 datë: 29.05.2025

Bazuar në nenin 12 pika 2 shkronja (d), nenin 58 shkronjat (d dhe h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Nenin 14 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës Nr.06/L-084 i dt.27.06.2019; Udhëzimin Administrativ të Qeverisë të Republikës së Kosovës (QRK) Nr.06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës; Rregulloren Komunale për mbrojtjen e fëmijëve numër, Npi – 01/177 datë: 31.08.2020; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Pikës 3 të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/197 të datës 27.05.2025. Duke vendosur lidhur me nevojën për miratimin e Planit të Punës së Ekipit për të drejtat e Fëmijëve 2025-2027, pas procesit të diskutimit publik me qytetarë më datën 22.05.2025, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më 29.05.2025, miratoi:

PLANI I PUNËS

SË EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2025 – 2027

Fjala e Kryetarit

Të dashur qytetarë,

Mbrojtja dhe përkrahja e fëmijëve është një ndër përgjegjësitë më të mëdha që kemi si shoqëri. Plani i Punës për të Drejtat e Fëmijëve, që e kemi hartuar me përkushtim të plotë në Komunën e Shtimes, paraqet një hap konkret dhe të qëndrueshëm drejt ndërtimit të një të ardhmeje më të mirë për gjeneratat e reja.

Ky plan nuk është vetëm një dokument strategjik, por një zotim moral e institucional që synon të përmirësojë cilësinë e jetës së çdo fëmije në komunën tonë. E ardhmja jonë ndërtohet sot – dhe ajo fillon me investimin në mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve tanë.

Në qendër të këtij plani janë disa fusha të rëndësishme:

- **Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës** – Do të investojmë në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, modernizimin e mësimdhënies, pajisjen e shkollave me mjete bashkëkohore dhe mbështetjen e mësimdhënësve. Synimi ynë është të sigurojmë që çdo fëmijë të ketë qasje të barabartë në arsim cilësor, pavarësisht prejardhjes apo gjendjes sociale.

- **Vendimarrja dhe mjedisi i sigurtë** – Dhuna ndaj fëmijëve, në çfarëdo forme, nuk ka vend në shoqërinë tonë. Do të forcojmë mekanizmat e parandalimit dhe raportimit të dhunës dhe do të punojmë ngushtë me institucionet, shkollat dhe komunitetin për të siguruar një mjedis të sigurt për çdo fëmijë.
- **Shëndeti dhe mirëqenia** – Përmes ofrimit të shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale, do të përkujdesemi që fëmijët të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor, mbështetje psikologjike dhe programe që përkrahin zhvillimin e tyre fizik dhe emocional.
- **Kultura, sporti dhe talentet e reja** – Do të krijojmë më shumë hapësira të dedikuara për zhvillimin e talenteve të reja në fushën e sportit, artit, kulturës dhe inovacionit. Qendrat rinore dhe objektet sportive do të jenë vende ku fëmijët do të mund të rriten, të mësojnë, të ëndërrojnë dhe të krijojnë.
- **Pjesëmarrja aktive e fëmijëve** – Besojmë fuqishëm se zëri i fëmijëve ka rëndësi. Prandaj, do të përfshijmë fëmijët në vendimarrje për çështje që i prekin drejtpërdrejt, duke i inkurajuar të jenë qytetarë aktivë dhe të angazhuar që në moshë të hershme.

Të nderuar qytetarë,

Zbatimi i këtij plani kërkon përkushtim të përbashkët nga të gjitha nivelet — institucionale, familjare dhe qytetare. Vetëm nëse punojmë së bashku, mund ta bëjmë Shtimen një komunë më të drejtë, më të sigurt dhe më mikpritëse për fëmijët tanë.

Le të ndërtojmë një të ardhme ku çdo fëmijë të ndihet i mbrojtur, i respektuar dhe i përkrahur.

Me përkushtim dhe respekt,

z.Qemajl Aliu

Kryetar i Komunës së Shtimes

Përmbajtja

Hyrje	5
Konteksti Global, Nacional dhe Lokal.....	6
Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë	7
Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit	9
Vetëdijësimi dhe avokimi si dhe siguri i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimarrëse për çështjet që lidhen me mirëqenjen e tyre.....	10
Krijimi i hapësirave publike të sigurt dhe miqësore për fëmijët	11
Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit.....	12
Bashkëveprimi i veprimit të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportit për gjendjen e fëmijëve në komunë.....	13
Referencat	13

Hyrje

Të drejtat e fëmijëve përbëjnë një nga themelet më të rëndësishme të zhvillimit shoqëror dhe të qëndrueshëm të një vendi. Në këtë frymë, Komuna e Shtimes, përmes Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve (EDF), ka hartuar këtë Plan të Punës si një dokument udhërrëfyes që përcakton prioritetet, objektivat dhe masat konkrete për përmirësimin e kushteve të jetesës, mbrojtjen dhe fuqizimin e fëmijëve në territorin e komunës sonë.

Ky plan është rezultat i një procesi të përbashkët pune ndërinstitutionale, konsultimesh me komunitetin, organizatat partnere, prindër dhe vetë fëmijët, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Objektivi ynë është të krijojmë një ambient të sigurt, gjithëpërfshirës dhe zhvillues për çdo fëmijë – pa dallim etnie, gjinie, aftësie apo statusi socio-ekonomik.

Plani adreson aspekte të rëndësishme si: arsimi cilësor dhe i qasshëm, mbrojtja nga dhuna dhe abuzimi, shëndeti dhe mirëqenia, zhvillimi kulturor e sportiv, si dhe fuqizimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimarrje. Nëpërmjet këtij dokumenti, synojmë jo vetëm të identifikojmë nevojat ekzistuese, por edhe të ndërtojmë mekanizmat e duhur për reagim, bashkëpunim institucional dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit.

Ekipi për të Drejtat e Fëmijëve do të jetë i angazhuar për zbatimin e këtij plani, në partneritet të ngushtë me institucionet publike, sektorin civil dhe qytetarët. Kjo përpjekje e përbashkët synon të shndërrojë komunën tonë në një hapësirë miqësore për fëmijët, ku ata ndihen të dëgjuar, të përfaqësuar dhe të vlerësuar.

Konteksti Global, Nacional dhe Lokal

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara (1989) përbën themelin ndërkombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe është dokument i ratifikuar në Kombet e Bashkuara. Ajo përcakton standardet minimale për sigurinë, zhvillimin, pjesëmarrjen dhe mirëqenien e çdo fëmije, pa përjashtim. Parimet themelore të Konventës janë të reflektuara jo vetëm në politikat globale dhe rajonale, por edhe në ato kombëtare dhe lokale. Ky Plan i Punës është i ndërtuar pikërisht mbi këto parime udhëzuese, duke i përshtatur ato në realitetin e Komunës së Shtimes.

Në nivel kombëtar, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt forcimit të mbrojtjes së fëmijëve përmes hartimit të politikave strategjike dhe krijimit të një kornize të qartë ligjore. Strategjia për të Drejtat e Fëmijës 2019–2023 ka përcaktuar obligime konkrete për institucionet publike, veçanërisht për nivelin lokal të qeverisjes, për të garantuar respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve. Objektivi i saj i dytë strategjik thekson qartë se autoritetet komunale duhet t'i japin përparësi të drejtave të fëmijëve, duke krijuar kushte për një jetë më të mirë brenda juridiksionit të tyre, në përputhje me Konventën dhe me legjislacionin vendor.

Një moment i rëndësishëm për Kosovën ishte miratimi i **Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës** në vitin 2019. Ky ligj përfaqëson një avancim thelbësor në garantimin e të drejtave të fëmijëve, pasi përcakton mekanizmat e domosdoshëm institucionalë për mbrojtjen dhe përkrahjen e tyre. Ndër të tjera, Ligji obligon themelimin e **Ekipeve për të Drejtat e Fëmijës** në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të cilat funksionojnë në nivel politik dhe koordinues lokal. Neni 20 i këtij ligji përcakton qartë rolin dhe fushëveprimin e këtyre ekipeve si struktura kyçe në zbatimin e politikave për fëmijët.

Për operacionalizimin e këtij ligji, në vitin 2022 është miratuar **Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2022**, i cili rregullon themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në nivel komunal. Ky udhëzim përshkruan përbërjen, përgjegjësitë dhe mënyrën e punës së këtij mekanizmi.

Në këtë frymë, në përputhje me UA 06/2022, Kryetari i Komunës së Shtimes, ka nxjerrë vendim tjetër duke bërë ndryshime në përbërjen e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës për shumë arsye, mbi 80% të antarëve tashmë nuk janë aktiv dhe duke e plotësuar listën e antarëve me të riijnë bazuar në udhëzimin administrativ për përbërjen e EDF, duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm në ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Ky plan i punës është rezultat i këtij angazhimi institucional dhe përfaqëson përkushtimin e Komunës së Shtimes për të ndërtuar politika dhe praktika që e vendosin fëmijën në qendër të zhvillimit lokal dhe të vendimmarrjes.

Ky plan trevjeçar pune i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është hartuar në përputhje me parimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, me politikat e nivelit qendror dhe lokal, si dhe me konceptin e komunave mike për fëmijë.

I. OFRIMI I SHERBIMEVE GJITHËPËRFSHIRËSE	OFRIMI I SHERBIMEVE CILËSORE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR FËMIJËT NË KOMUNË
1. AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
1.1 Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë	• Bëhet ekzaminimi /evidentimi i fëmijëve në komunë. • Zhvillohet katalogu i llojeve të shërbimeve komunale dhe ofruesëve të shërbimeve. • Organizohet një fushatë informuese përmes institucioneve publike, medias lokale dhe web faqes së komunës.
1.2 Ndarja e fondit për fëmijë në rrethana të jashtëzakonshme	• Identifikohen nevojat për shërbime. • Kontraktohen operatorët ekonomik për ofrimin e shërbimeve emergjente për fëmijët si (mallëra, ushqim, transport etj.).
1.3 Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore	• Promovohet koncepti i familjeve strehuese dhe farefisnore • Bëhet identifikimi dhe vlerësimi i familjeve strehuese dhe farefisnore • Trajtohen familjet strehuese dhe farefisnore • Ofrohet strehimi dhe monitorohet trajtimi i fëmijëve brenda këtyre familjeve
1.4 Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimi pozitiv	• Përshtaten modulet/praktikat ekzistuese të prindërimit më të mirë për nevojat të komunitetit. • Krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trainimit (trajnimi i trajnerëve), p.sh. psikologët në shkollë, edukatorët, profesionistët shëndetësorë, etj • Shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve/sesioneve informative.
1.5 Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për tu regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën	• Bashkëpunohet me zyrën e regjistrimit civil dhe merren informata për të gjithë fëmijëve të moshës shkollore të komunës. • Regjistrohen nxënësit duke respektuar rregulloren komunale • Mirëmbahet baza e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit SMIA-s

	• Funksionalizohen Ekipet për parandalimin dhe Reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM) • Bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim
1.6 Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla	• Trajtohen mësimdhënës për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjik dhe psikosociale • Krijohen/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale. • Identifikohen nevojat për mësimdhënës mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara • Punësohen mësimdhënës mbështetës.
1.7 Inspektimi i cilësisë së hapësirës shkollore	• Angazhohen ekipe profesionale për inspektim të gjendjes së shkollave (inspektimi i vjetërsisë të objekteve, paisjeve shkollore, etj) • Inspektohen objektet shkollore në baza vjetore dhe hartohen raporte • Ndërmerren masa përmirësuese bazuar në raportet • Promovohen standardet për shkollat mike për fëmijë
1.8 Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtjen e mjediseve shkollore	• Vetëdijësohen nxënësit dhe palët tjera për nevojën e mirëmbajtjes së shkollave • Hartohet një udhëzim me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore • Shpërblehet komunitetet më të veshme shkollore

II. SHËNDETI DHE MIRËQENIA	PROMOVIMI SHËNDETËSOR, PËRMES INFORMIMIT, KOMUNIKIMIT DHE EDUKIMIT
2. AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
2.1 Informimi shëndetësorë për fëmijë dhe adoleshentë	• Ndërmerret fushatë vetëdijësuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve. • Organizohen ligjerata për edukimin shëndetësor dhe reprodutiv për nxënësit e shkollave, përmes sistemit të ligjeratave të profesionistëve shëndetësorë. • Organizohen ligjerata për parandalimin e abuzimit me substanca
2.2 Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët në baza periodike	• Zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënave dhe fëmijëve të vegjël, për këshilla për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe për përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme. • Organizohen vizita shëndetësore në shtëpi për nënat dhe fëmijët. • Zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal • Organizohen shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, me komponentën e intervenimit shëndetësorë dhe atij edukativ • Realizohen kontrollat sistematike shëndetësore nëpër shkolla.
2.3 Identifikimi i hershëm i fëmijëve me nevoja të veqanta	• Përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me nevoja të veqanta • Promovohen shërbimet institucionale dhe të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijë me nevoja të veqanta, me fokus në përfitimet e FNV dhe familjare. • Hartohet/përdoret dokumenti (formulari) për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijut, gjat regjistrimit në shkollë • Bëhen vlerësime të fëmijëve në nevojë dhe rekomandohen masat që duhet ndërmarrë shkolla (mësidhënësit) menaxhmenti i shkollës, prindërit).
2.4 Ofrimi i shërbimeve të veqanta për fëmijët në nevojë	• Subvencionohen organizatat e licencuara që ofrohen shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim të bazuar në bashkësi për fëmijët me aftësi të kufizuara • Identifikohen nevojat dhe sigurohet qasja fizike e fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapsirat publike • Ofrohen programe të mbështjettjes shtesë për fëmijët nga grupet e cenueshme (komunitetit rom, ashkali, dhe egjiptian. Fëmijët nga situata rrugëlëmozhëkerkues, fëmijët që punojnë, fëmijët e trafikut, etj.). Të tilla si mësimi shtesë përmes qendrave mësimore, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi etj. • Avancohet komunikimi ndërmjet palëve kryesore (qendrave për punë sociale, kujdesit parësorë shëndetësorë). Personelit arsimor, Policisë, Gjykatës, Organizatave Joqeveritare etj, për një referim dhe kujdesi ndaj fëmijëve në nevojë.

III. PJESËMARRJA AKTIVE E FËMIJËVE DHE VENDIMARRJA	VETËDIJËSIMIT DHE AVOKIMIT SI DHE SIGURIMI I PJESËMARRJES SË FËMIJËVE NË PROCESET VENDIMARRËSE PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME MIRËQENJEN E TYRE
3. AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
3.1 Ngritja e kapaciteteve të politikbërësve dhe zyrtarëve komunal për aspekte të drejtave të fëmijëve	• Ofrohen trajnimet për politikbërësit dhe zyrtaret komunal në fushën e të drejtave dhe mirëqenjes së fëmijës
3.2 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të rriturit dhe për fëmijët	• Planifikohen dhe organizohen fushata vetëdijësuese dhe shpërndahen materiale promovuese për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e tyre
3.3 Mbështjetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës	• Përkrahet puna e organizatave joqeveritare , koalicioneve e rrjeteve që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve • Mundësohet dhe përkrahet puna e vetëstrukturave organizative të fëmijëve dhe të rinjëve
3.4 Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias	• Ofrohen udhëzues dhe trainime për zyren për marrëdhënje me publikun, për sekretariatit e Ekipit dhe mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike • Përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale • Organizohen forume diskutimi në mes komunës lidhur me standardet e mbrojtjes së identitetit dhe integritetit të fëmijëve
3.5 Përcaktimi dhe zbatimi i proced. të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimarrjes	• Hartohet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit me fëmijë që në faza të hershme të proceseve vendimarrëse • Monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë
3.6 Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve	• Nxitet funksioni i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet • Trajtohen përfaqësuesit e nxënësve për udhëheqje dhe aktivizim qytetar • Promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmime të dhunës në shkollë.

IV. HAPËRIRAT TË SIGURTA DHE MIQËSORE PËR FËMIJËT	KRIJIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE TË SIGURTA DHE MIQËSORE PËR FËMIJËT
4. AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
4.1 Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët	• Hartohen dhe realizohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorët, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, sinjalizimi i shtigjeve të biçikletave etj. • Bëhen fushata informimi me të gjithë pjesëmarrësit për sigurinë në trafik
4.2 Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik	• Promovohet linja telefonike për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe merren masa për eliminimin e tyre në afat sa më të shkurtër • Menaxhohen/sistemohen qenët endacak • Merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës (personat e pautorizuar, shitja e artikujve të dëmshëm, etj). • Rritet sipërfaqja e hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.

V. KULTURA, SPORTI DHE TALENTET E REJA	ZHVILLIMI I FËMIJËVE PËRMES SPORTEVE, LOJËS DHE REKREACIONIT
5. AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
5.1 Promovimi i sportit nëpër shkolla	• Ngritja e kapaciteteve të shkollave për promovimin e sportit shkollor • Krijohen/zhvillohen klubet sportive shkollore • Organizohen gara sportive mes shkollave
5.2 Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja	• Nxitet regrutimi i fëmijëve djem e vajza nëpër klube sportive • Mbështeten kampe për identifikimin e talenteve në sporte
5.3 Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë	• Nxitet themelimi /fursionimi i klubeve të artistëve të kulturës, nëpër shkolla • Organizohen aktivitete të përbashkëta të klubeve artistike e kulturore të shkollave dhe të organizatave të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klubeve letrare, etj. • Ofrohet më shumë hapësirë nëpër shkolla e gjetiu që fëmijët të zhvillojnë shkathtësitë teknologjike si: programim, kodim, web dizajn, etj.
5.4 Ofrimi i hapësirave jo formale për rekreacion	• Inspektohen parqet ekzistuese dhe identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë. • Intervenohet në adaptimin e hapësirave eksistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja • Krijohen ekipe të përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative.
5.5 Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin	• Organizohen kampe të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. për fëmijët e shkollave dhe organizatave të fëmijëve • Organizohen vizita e takime në institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut/fëmijëve. • Angazhohen fëmijët dhe të rinjtë në aktivitete në përfitim të komunitetit (mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik).

VI. VLERËSIMI DHE RAPORTIMI	BASHKËVEPRIMI I VEPRIMIT TË TË GJITHA PALËVE PËRMES PROCESIT TË KOORDINIMIT, SI DHE PËRMES VLERËSIMIT DHE RAPORTIT PËR GJENDJEN E FËMIJËVE NË KOMUNË.
7. AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
6.1 Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve	- Realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes që do të shërbejë për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të planit të punës - Bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës. - Diskutohen raportet në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikatat të qeverisjes lokale
6.2 Kordinimi me palet relevante	Mbahet komunikim bashkëpunimi sipas nevojës me palet e tjera në nivel qendror, lokal dhe në nivel të komunitetit
6.3 Vlerësimi dhe raportimi	- Bëhet vlerësimi periodik (çdo 6 muaj) i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti - Bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti përfundimtar

Referencat:

<https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

<https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/05/Alb-Track-Changes-Strategjia-per-te-drejtat-e-femijeve-FINAL-12032019.pdf>

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596>



KRYESUESI I KUVENDIT
Adnan Ademi